



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 548/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Habib Mustafës në cilësinë e Menaxherit të Qendrës së Votimit 2717B në fshatin Strovç komuna e Vushtrrisë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 15.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHET ankesa si e pabazuar e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjektit politik AAK, me të cilën pretendohet se në fshatin Strovç komuna e Vushtrrisë „Habib Mustafa në cilësinë e Menaxherit të Qendrës së Votimit (QV) 2717B, ka pas konflikt interesi dhe shkelje e dispozitave ligjore zgjedhore ngase kryesuesi i kësaj qendre është anëtar i kuvendit komunal si dhe ushtrues detyre i drejtorit të Shkollës fillore “ILIRIA” në Strovç. Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e pabazuar.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, janë të pabazuara për shkak se nuk janë ofruar dëshmi për të besuar se ka pasur shkelje të dispozitave ligjore zgjedhore dhe konflikt interesi. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 548/2010 më datën 15.12.2010.

